ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA E GJAKOVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **632-22-5204-1-2-1**

Sa i përket tenderit për : **Furnizim me pajisje bujqësore**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

BAJRA N.P.T.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Lidhja e Prizrenit

(Adresa)

Prishtinë — *10000*

(Vendi) — *(Kodi postar)*

044232956

(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Nehat Raifi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

nehati_r@hotmail.com

(Adresa elektronike)

29/06/2022

(Data e parashtrimit të ankesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

B05 Njoftim per Kontrat 06.06.2022 00:00 03.06.2022 00:00
B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara 08.06.2022
Dosja e Tenderit-Furnizim me pajisje bujqësore -2022.Doc - Versioni i tanishëm: 07.06.2022 12:00
Kwrkesa pwr Rishqyrtim – 15.06.2022
VENDIMI PER PEZULLIM-Furnizim me pajisje bujqësore-Bajra-16.06.2022.pdf - Versioni i tanishëm: 16.06.2022 09:28
Vend.per Rishq.-Furnizim me pajisje bujqësore -Bajra-20.06.2022.pdf - Versioni i tanishëm: 20.06.2022 15:04

Afati për dorëzimin e ofertave/kërkesës për pjesëmarrje 29.06.2022 13:30

IV.1.1) Lloji i procedurës T E hapur

IV.2) KRITERET E DHËNIES T Çmimi më i ulët

NDËRMARRJA PRIVATE TREGTARE BAJRA 1 PRISHTINË

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☐

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ ***Jo*** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☐ **Jo** ☐

Lidhur me detaje mbi këtë fakt gjeni të bashkëngjitur kërkesën për rishqyrtim dhe vendimin/përgjigjen e AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A te LPP-së.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

LIGJI Nr. 04/L-042
Neni 1. Qëllimi LPP
Neni 6. Ekonomiciteti dhe Efikasiteti LPP
Neni 7. Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi LPP
Neni 28. Specifikimet Teknike LPP
Neni 68. LPP / RRUOPP
Neni 69. LPP / RRUOPP
Neni 20. RRUOPP

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

NDËRMARRJA PRIVATE TRAFIGTARE BABA 1 PRISHTINË

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar, ne OE Bajra NPT kemi bërë kërkesë për Rishqyrtim në AK Komuna e Gjakovës lidhur me aktivitetin e Prokurimit **Furnizim me pajisje bujqësore me nr.Prokurimi: 632-22-5204-1-2-1** më datë 15.06.22;
Autoriteti Kontraktues ka bërë Pezullimin e Aktivitetit të Prokurimit në fjalë më datë 16.06.22;
Autoriteti Kontraktues ka nxjerr Vendimin për Refuzimin e kërkesës sonë me të cilën vendim ne si OE nuk pajtohemi më datë 20.06.22. Ne kemi dërguar kërkesën për Rishqyrtim tek AK-ja meqë ky autoritet kontraktues ka hartuar specifika të cilat i'a ka përshtatur operatorëve të caktuar ekonomik në kundërshtim me Nenin 28 të LPP-së duke i'a pamundësuar OE të interesuar pjesëmarrjen në këtë aktivitet të prokurimit dhe njëkohësisht duke e favorizuar një OE të caktuar.

Kërkesa nr. 1.
Ne kemi kërkuar nga AK të ndryshojë kërkesën e dosjes së tenderit në lidhje me numrin e thikave të kërkuara, pra të caktoj një minimum dhe maksimum tw tyre për të lejuar pjesëmarrje sa mw tw hapur të operatorëve në këtë aktivitet prokurimi:

> *1.* Numri i thikave të kërkuara është 24. *Sipas RRUOPP-së Neni 20.4 "Specifikimet teknike do të ofrojnë qasje të barabartë për tenderuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të paarsyeshme në hapjen e konkurrencës së prokurimit publik."* Motokultivatorët me fuqi 7.5 kë kanë mundësi funksionimi më të lehtë dhe performancë të njejtë me numër të thikave edhe më të vogël psh. 20 (10+10) kjo për shkak të ruajtjes se fortësisë së boshtit andaj konsiderojmë se një specifikë e tillë teknike është shumë e kufizuar. Specifika teknike si kjo në të cilat nuk janë lejuar minimume dhe maksimume shkelin dispozita ligjore të LPP-së duke favorizuar një prodhues dhe duke diskriminuar prodhues/OE të tjerë *Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi paragrafi 1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.*
> *Si dhe paragrafi 6. Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit;*

Ndërsa nga AK-ja kjo kërkesë e jona është refuzuar me pretendimin si në vijim me të cilin ne nuk pajtohemi pasi AK-ja ka vendosur minimumin e specifikave që i përshtaten motokultivatorit LABIN ndërsa ka lënë hapësirë për maksimume që realisht hapësirat e lejuara nuk përkojnë fare me realitetin, pasi nuk ekziston motokultivator që i përshtatet kërkesave të tjera teknike të përcaktuara në DT dhe i cili mund të ketë numër të thikave me të madh se 24 përveçse motokultivatorit të brendit LABIN.

NDËRMARRJA PRIVATE TREGTARE BAJRA 1 PRISHTINË

1. Numri I kerkuar I thikave per motokultivator eshte 24: ne dosje te tenderit perkatesisht tek Paramasa vendosen speicifikat minimale te kerkuara te cilat qdo autoritet kontraktues I kerkon per nje project apo tener, operatoret ekonomik te cilat shprehin interesim per pjesemarrje ne tender mund te ofertojn produktet te barazvleshme por jo nen kerkese minimale te kerkuar nga autoriteti kontraktues, qe nenkupton kerkesa minimale e jona eshte qe kto frezat per motokultivator numrin e thikave te e ken 24copa, ndersa Operator Ekonomik mund te ofertojn freza me numer te madh te thikave. Per hir te transparences arsyetimi I Operatorit Ekonomik ankues se numri me I vogel I thikave e rruan fortesin e bushtit nuk qendron ngase boshtet e frezave e fortesia e tyre prodhohen duke u bazuar ne numrin e thikave, diametrin e thikes si dhe peshen e thikes, e te cilat pastaj testohen e certifikohen nga kompanit te licensuar te pamvarura ne shtetet e tyre prodhuese. Numri me I madh I thikave nenkupton gjeresin dhe kualitetin e frezimit te tokes andaj kerkesa jone eshte qe numri minimale I thikave te frezes per motokultivator eshte 24cope.

Arsyetimi i dhënë nga AK nuk qëndron fare pasi numri më i madh i thikave rëndon funksionimin e motorit që dmth numër më i vogël i thikave për motokultivator me fuqi 7.5Kw bënë që motori të funksionojë më me lehtësi dhe pa u rënduar. Çdo pajisje mekanike që përmban në tërësinë e saj më shumë elemente siç është numri i thikave në këtë rast për një motor me fuqi të caktuar bënë më tepër të rëndojë funksionimin stabil të saj. Çdo përpjekje e rënduar për të vënë në lëvizje një numër më të thikave në këtë rast bënë që motori të dobësohet më shpejt si dhe boshti të humbet fortësinë e tij. Për më tepër një motor motokultivatori që punon duke u rënduar shpenzon më shumë karburant dhe duke pasur parasysh kërkesën e AK për motokultivator dieseli, i bie që të kemi një mjedis më të ndotur në përgjithësi dhe dëm të shëndetit të fermerit në veçanti.

Pra nga faktet dhe sqarimet e lartcekura kuptohet qartë se AK-ja me kërkesën e sa po e favorizon një OE të caktuar duke e kufizuar konkurrencën në këtë aktivitet të prokurimit, pasi që e njëjta e ka cekur se lejohet të ofertohet me një numër më të madh të thikave mirëpo jo nën 24 thika, kërkesë kjo diskriminuese për OE të interesuar në këtë aktivitet të prokurimit, pasi që siç edhe e cekëm më lart kjo kërkesë i favorizon vetëm OE të cilët do të ofertojnë më brendin e motokultivatorit LABIN.

Prandaj kërkojmë nga OSHP që të aprovojë kërkesën tonë dhe të detyrojë AK të ndryshojë këtë specifikë teknike duke lejuar pjesëmarrjen me motokultivator që kanë numër të thikave me minimumi 20, sepse nëse nuk ndryshohet kjo kërkesë atëherë kuptohet qartë se ky aktivitet i prokurimit është iniciuar dhe destinuar për OE të caktuar.

Kërkesa nr.2.

2. Shtysa ndihmëse:
   Boshti i shtyses së epërme dhe shtyses së kardanit FI 30 – kërkojmë lejminin e tolerancës (psh. 20-35 mmFI) pasi një kërkesë e tillë është në kundërshim me ***Neni 28 Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.***

Edhe këtë kërkesë tonën autoriteti kontraktues e ka refuzuar duke thënë që operatorët ekonomik mund të ofertojnë me motokultivator që kanë bosht shtytës më të madh se 30FI dhe se kërkesa për bosht shtytës FI30 është specifikë teknike minimale, edhe kjo specifike teknike është e përshtatur për motokultivator LABIN. Ne, si OE nuk pajtohemi me arsyetimin e AK pasi kjo kërkesë teknike minimale është bërë për operator të caktuar ekonomik prandaj është vendosur si minimum kjo specifikë teknike duke e ditur që ndër këtë minimum ka prodhues tjerë në treg ndërsa prodhues të motokultivatorëve me FI30 bosht shtytës është vetëm prodhuesi LABIN ndërsa mbi këtë parametër

NDËRMARRJA PRIVATE TREGTARE BAJRA 1 PRISHTINË

nuk ka fare prodhues në kategorinë e motokultivatorëve. Pra edhe në këtë pikë AK-ja e ka shkelur Neni 28 i LPP-së –Specifikimet Teknike dhe Neni 7 i LPP-së Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminimi si dhe Neni 20, Paragrafi 20.4 i RRUOPP-së, Specifikimet /TER ***do të jetë e qartë, e saktë dhe precize dhe duhet të mos paraqet kufizime të panevojshme, në mënyrë që të mos kufizohet konkurrenca. Ato duhet të përkufizohen në mënyrë që mos të krijojnë dyshime rreth natyrës së mallrave, punëve ose shërbimeve të kërkuara.***

> ***"Specifikimet teknike do të ofrojnë qasje të barabartë për tenderuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të paarsyeshme në hapjen e konkurrencës së prokurimit publik."***

Kështu siç AK-ja i ka përcaktuar specifikat teknike, kuptohet qartë se ky aktivitet i prokurimit është i përgatitur për një OE të caktuar i cili posedon motokultivatorët të cilët i përshtaten kërkesave të AK-së.

AK-ja në këtë rast me këto kërkesa, nuk e ka pasur parasysh nenin 26.4 të Rregullave dhe Udhëzuesit operativ për prokurim publik, sepse aty shkruan qartë se *"Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do ti kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike"*. Pra jo vetëm që AK-ja po ju pamundëson ofertimin operatorëve ekonomik të themeluar rishtazi në kundërshtim me nenin e lartcekur por po ju pamundëson ofertimin edhe OE me përvojë të madhe në këtë fushë.

Andaj konform sqarimit të lartcekur kërkojmë nga OSHP-ja që të detyroj AK të bëj ndryshimin e kërkesës së lartcekur të kontestuar nga ana jonë dhe të lejoj ofertimin me motokultivator që kanë bosht shtytës me minimum 20 dhe maksimum 35 FI, pasi që në këtë mënyrë do të hapej konkurrenca dhe mundësia e dëmtimit të buxhetit të shtetit do të ishte shumë e vogël pothuajse fare.

Kërkesa nr.3.

Autoriteti Kontraktues ka vendosur si kriter tek kërkesat e përshtatshmërisë profesionale certifikatat si ISO 9001:2015, ISO 45001:2018 dhe ISO 14001:2015, kërkesë kjo e panevojshme e cila direkt eliminon në masë të madhe shumë operator ekonomik.

NDËRMARRJA PRIVATE TREGTARE BAJRA 1 PRISHTINË

7. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licenca ISO - ISO 9001 2015 te jetë valide, Sistemi i Menaxhimit të cilsisë ,ISO-45001 2018 te jetë valide- Sistemi i Menaxhimit të Shendetit dhe sigurisë profesionale, ISO 14001 2015 te jetë valide, Sistemi i

Menaxhimit mjedisor. **Kërkojmë nga autoriteti juaj të anuloj këtë kriter diskriminues për OE Natyra e kontratës është furnizim dhe këtë pjesë e mbulon në tërësi ISO 9001:2015 si standard për një sistem të menaxhimit të cilësisë kur një organizatë:**

a) duhet të demonstrojë aftësinë e saj për të ofruar vazhdimisht produkte dhe shërbime që plotësojnë kërkesat e klientëve dhe të zbatueshëm ligjorë dhe rregullatorë, dhe

b) Synon të përmirësojë kënaqësinë e klientit përmes aplikimit efektiv të sistemit, përfshirë proceset për përmirësimin e sistemit dhe sigurimin e konformitetit me klientët dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Të gjitha kërkesat e ISO 9001: 2015 janë të përgjithshme dhe ato duhet të jenë të zbatueshme për çdo organizatë, pavarësisht nga llojet ose madhësia e saj, ose produktet dhe shërbimet që ajo ofron. Kjo dispozitë shkel Nenin 7 të LPP-së Barazim në Trajtim / Jo – Diskriminimi. Andaj kërkojmë të anulohet si kriter nga kërkesat e përshtatshmërisë profesionale. ISO 45001 Standard që ka të bëjë me sigurinë dhe shëndetin e puëntorëve dhe ISO 14001 Standard që ka të bëjë me menagjimin e mjedisit, pra asnjëri standard nuk ka të bëjë me cilësin dhe kualitetin e produkteve / pajisjeve. Kualiteti / cilësia përmbushet me ISO 9001:2015.

Më datë 20.06.2022 nga Autoriteti Kontraktues është refuzuar kjo kërkesë e jona me arsyetimin si në vijim:

NDËRMARRJA PRIVATE TREGTARE BAJRA 1 PRISHTINË

7. Duke zbatuar ligjin e prokurimit public Ligji Nr.04/L-042 I ndryshuar dhe plotesuar me ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin Nr.05/L-092, Neni 69 – Aftesia teknike dhe/ose Profesionale: ne kemi kerkuar qe Operatoret Ekonomik pjesemarres duhet te jene te certifikuar me Iso Standarde Iso 9001:2015, Iso 45001:2018 dhe Iso 14001:2015 pershkak se:

a) Iso 9011:2015 – ka te beje me sistemin e menaxhimit te cilesis qe nenkupton Operatoret Ekonomik I cili do te beje furnizimin me keto paisje jane te standardizuar per nga ana e cilesis se produkteve qe ata ofrojne nga nje kompani e pamvarur e licensuara per standardizim ne Kosove.

b) Iso 45001:2018 – ky standard ka te beje me menaxhimin, shendetin dhe sigurise profesionale te puntoreve qe ata I kane, e ky kriter tregon profesionalizmin e kompanise dhe seriozitetin e saj per sa ka te beje me kualitetin dhe funksionalitetin e produkteve qe ata ofrojn

c) Iso 14001:2015 – Sistemi I menaxhimit mjedisor: qellimi I te gjitheve eshte mbrojtja e sistemit mjedisor dhe nje kompani e standardizuar me kete standard nenkupton qe paisjet te cilat ata posedojn nuk e degradojn apo demtojn sistemin mjedisor.

Ne, si OE nuk pajtohemi me vendimin e autoritetit kontraktues në pikën b)ISO 45001:2018 për këto arsye:

a), *është kërkesë shumë e kufizuar në favor të një operatori ekonomik dhe në dëm të shumë OE të tjerë,*

b*), menaxhimi i shëndetit dhe sigurisë profesionale të punëtorëve nuk mbulohet vetëm me Certifikatë ISO 45001:2018.* Ju sqarojmë se me Ligjin e Punës në Kosovë kompanitë dhe institucionet janë të obliguara të kenë Raportin e Vlerësimin të Riskut raport i cili trajton Menaxhimin e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë . Një raport i tillë është i ndërtuar mbi bazën e ISO 45001:2018 dhe OHSAS 18001 Standarde këto për Menaxhimin e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë dhe që ka vlerë jashtëzakonisht të madhe për punëtorin, shëndetin e tij dhe profesionalizmin e një kompanie. Po ashtu Raporti për Vlerësimin e Riskut mbi Menaxhimin e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë është raport që përfshin në vete trajnimin për secilin të punësuar në kompani pra, ky raport është më shumë se një standard pasi nuk është i kufizuar vetëm në procedurat orientuese dhe zbatuese të kompanisë por është raport që pikë së pari është i orientuar në vetë të punësuarit e pastaj shtrihet në pjesë të tjera të kompanisë gjithmonë brenda kufijve të sigurisë dhe shëndetit në punë.

c). Me cilësinë e produkteve lidhet direkt ISO 9001:2015 ndërsa arsyetimi i AK që ISO 45001:2018 si standard që ka të bëjë me shëndetin dhe sigurinë profesionale të punëtorëve tregon *seriozitetin e saj për sa ka të bëjë me kualitetin dhe funksionalitetin e produkteve që ata ofrojnë* **është arsyetim i pabazë.** Shëndeti dhe Siguria në punë lidhen direkt me të punësuarin dhe këtu nuk ka vend interpretimi për kualitet produkti pasi këtë fushë e mbulon ISO 9001:2015.

Andaj duke u bazuar në sqarimin e lartcekur i cili është i bazuar në fakte konkrete, kërkojmë nga OSHP që të detyrojë autoritetin kontraktues të ndryshojë kërkesat e përshtatshmërisë profesionale duke na lejuar pjesëmarrjen në këtë aktivitet prokurimi me këtë raport. Raportin e Vlerësimit të Riskut - Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë. Shumë autoritete kontraktuese aplikojnë kërkesat e nenit 68 dhe / ose 69 të LPP-së edhe për aktivitete të prokurimit kur nuk kanë rëndësi të madhe apo kërkohet që të dështohet një përshtatshmëri profesionale e tillë. *Aktivitetet e prokurimi të cilat kanë për qëllim furnizimin me mallëra e të cilat nuk prodhohen nga ofruesi i tyre dhe vendosin kritere të tillë si këto standarde janë të paarsyeshme / joprofesionale dhe pengojnë realizimin e aktiviteteve duke shkaktuar probleme dhe vonesa të panevojshme.*

BAJRA

Këshille: Shume AK i aplikojnë kërkesat e nenit 68 dhe/ose 69 te LPP-se edhe për rastet kur nuk kanë ndonjë rëndësi apo nevoje për tu dëshmuar (p.sh. për aktivitetet te cilat kanë për qellim furnizimin me mallra e te cilat nuk prodhohen nga ofruesi i tyre). Ne këto aktivitete aplikimi i kritereve nga neni 68 dhe/ose 69 nuk është i arsyeshëm përkundrazi është jo profesional dhe mund te shkaktoj probleme te panevojshme.

Pra duke u bazuar në faktet e lartcekura kuptohet qartë diskriminimi i hapur që po ju bëhet OE të interesuar në këtë aktivitet të prokurimit nga ana e AK-së, e cila po ju kufizon pjesëmarrjen dhe njëkohësisht edhe konkurrencën në këtë aktivitet të prokurimit, duke e favorizuar haptas një OE të caktuar. Pasi që arsyetimet e saj në vendimin për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim janë krejtësisht të pa bazuara dhe të pa mbështetura në dispozita ligjore sepse kërkesat e saj janë të pa nevojshme dhe të njëjtat vetëm sa e ngarkojnë dosjen e tenderit, ndërsa kur ndryshohet kërkesa sipas pretendimit tonë ankimor, atëherë bëhet hapja e konkurrencës dhe buxheti i shtetit kursehet në masë të madhe.

Kërkesa nr.4.

Ne kemi kërkuar nga autoriteti kontraktues vendosjen e specifikave minimale dhe maksimale për pajisjet si:

1. Makinë për përzierjen e ushqimit të kafshëve,
2. Mbjellëse 4 –rendëshe automatike e misrit dhe
3. Spërkatëse,

> 9. Specifikacioni i pajisjes: *Makina për përzierjen e ushqimit të kafshëve*, janë vendosur specifika teknike fikse, **Neni 28 Autoriteti Kontraktues** është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik. Kërkojmë të lejohen minimumet dhe makismumet.
>
> 10. Specifikacioni i pajisjes: *"Mbjellëse 4 rende automatike e misrit"* janë vendosur dimenzione të përgjithshmë fikse: 2800*1620*1100mm. Kërkojmë të vendosen minimumet dhe maksimumet e lejuara. Specifika të tilla fikse shkelin Neni-n 7. Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi të LPP-së si dhe është në kundërshtim me nenin 28 të LPP-së.
>
> 11. Specifikacioni i pajisjes: "Spërkatëse" janë vendosur kritere favorizuese dhe aspak të rëndësishme për funksionimin e pajisjes si p.sh. dimensione fikse të konstruksionit të krahëve andaj kërkojmë të eliminohen si specifika teknike apo të vendosen minimume dhe maksimume. Poashtu kërkojmë që tek specifika teknike e presionit të pompës të vendosen minimum maksimumet p.sh 40-50 bar. Specifika të tilla fikse shkelin Neni-n 7. Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi të LPP-së si dhe është në kundërshtim me nenin 28 të LPP-së.

Përcaktimi i kritereve minimale nga ana e AK-së aludon dhe favorizon pajisje, prodhues dhe operator të caktuar ekonomik por edhe në këto kërkesa tona AK është arsyetuar se kinse specifikat e vendosura janë kërkesa minimale dhe operatorët ekonomik mund të ofertojnë edhe me specifika më të larta dhe të barasvlefshme se këto të përcaktuara në DT por janë ndër ato që janë përcaktuar në DT.

NDËRMARRJA PRIVATE TREGTARE BAJRA 1 PRISHTINË

9. Per makina per perzierjen e ushqimit te kafsheve: specifikat teknike tek paramasa jane kerkesa minimale, Operatoret Ekonomik mund te ofertojn paisje te barazvleshme por asnjehere nen kerkes minimale te kerkuar nga AK.
10. Mbjellese 4 rende automatike e miserit: specifikat teknike tek paramasa jane kerkesa minimale, Operatoret Ekonomik mund te ofertojn paisje te barazvleshme por asnjehere nen kerkes minimale te kerkuar nga AK.
11. Sperkateset: specifikat teknike tek paramasa jane kerkesa minimale, Operatoret Ekonomik mund te ofertojn paisje te barazvleshme por asnjehere nen kerkes minimale te kerkuar nga AK. Per dimensioned e konstruksionit te krahve nuk mund te largohet (kerkes e operatorit ekonomik ankues) ngase jane kerkesat minimale qe kerkohen dhe qe plotesojn standardet minimale te nje sperkateses andaj ato mbesin si te tilla.

b) Minimumi I presionit te pompes eshte 50bar, Operatore ekonomik mund te ofertojn paisje te barazvleshme por asnjeher nen kerkes minimale te kerkuara nga AK.

Duam të kujtojmë autoritetin kontraktues se parametrat minimal në këtë aktivitet prokurimi të vendosura nga ana e tyre janë parametra determinues për prodhues të caktuar prandaj ne nuk pajtohemi me vendimin e tyre dhe duhet të lejohet minimumi dhe maksimumi ashti siç e kemi cekur në kërkesën për rishqyrtim, pasi që në këtë mënyrë siç janë hartuar specifikat teknike nuk mund të zhvillohet një procedurë e hapur për të gjithë OE, mirëpo kufizohet konkurrenca dhe ju pamundësohet OE të interesuar të ofertojnë në këtë aktivitet të prokurimit. **Kërkojmë nga OSHP të aprovojë kërkesën tonë dhe të detyrojë autoritetin kontraktues të vendosë parametra minimal dhe maksimal poshtë dhe lartë parametrave të përcaktuar në DT.** Parametrat minimal të përcaktuar nuk janë parametra që ka qenë e duhur të përcaktohen detyrimisht pastaj edhe po të ishin këto kërkesa direkte të fermerëve apo njësive kërkuese përgjegjës për shpalljen e tyre është prokurimi prandaj edhe kërkesat e tilla në rast se ndodhin duhet përmirësuar dhe rregulluar konform ligjit dhe rregulloreve të prokurimit publik.

Me këto kërkesa nuk mundësohet pjesëmarrje e gjerë e operatorëve ekonomik, por në këtë mënyrë është kufizuar tej mase konkurrenca dhe këto kërkesa janë drejtpërdrejtë jo në harmoni me çmimin dhe lëndën e prokurimit, sepse kur kufizohet konkurrenca me kërkesa të pa nevojshme atëherë edhe çmimi ofertues i operatorëve ekonomik të favorizuar automatikisht është shumë më i lartë, ndërsa kjo ndodh për shkak se nuk kanë konkurrencë dhe faktikisht determinohet çmimi nga ana e autoritetit kontraktues në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit.

Duke u bazuar në të gjitha këto kërkesa diskriminuese-favorizues dhe në dështmitë e kërkuara, rezulton se në këtë mënyrë nuk mund të arrihet qëllimi këtij aktiviteti të prokurimit dhe qëllimi i LPP-së, siç parashihet në nenin 1 të këtij ligji, e ku shkruan qartë: *Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.*

Kërkesat e lartcekura bien në kundërshtim me nenin 7 paragrafi 1, 3, 4 dhe 6 të LPP-së, sepse në këta paragraf parashihet qartë që operatorët ekonomik nuk mund të diskriminohen në asnjë mënyrë dhe në asnjë variant. Prandaj kërkesat të cilat i kontestuam më lartë duhet larguar/ndryshuar për të pasur një aktivitet të prokurimit normal dhe për të mos u diskriminuar/favorizuar kompanitë e caktuara.

Prandaj të gjitha kërkesat të cilat i kontestuam më lartë duhet larguar/ndryshuar për të pasur një aktivitet të prokurimit normal dhe për të mos u diskriminuar/favorizuar kompanitë e caktuara.

BAJRA 1 PRISHTINË

Krejt në fund, kur kemi parasysh të gjitha faktet dhe dëshmitë që u përmendën më lartë dhe kërkesat favorizuese/diskriminuese, ju njoftojmë se nëse nuk ndryshohen këto kërkesa, ne nuk do të ndalemi me kërkesë për rishqyrtim/ankesë por do të vazhdojmë procedurat ligjore edhe në institucionet tjera administrative.

Prandaj duke u bazuar në të gjitha faktet dhe dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

V E N D I M

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE **"BAJRA"NPT**
ANULOHET, vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim nga Autoriteti Kontraktues,
DETYROHET autoriteti kontraktues të bëjë ndryshimet në lidhje me kërkesat që u cekën më lartë nga ana jonë dhe pastaj të veprohet konform nenit 53 të LPP-së.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

- Neve si Operator Ekonomik po na shkaktohet padrejtësisht pengesë në zhvillimin e veprimtarisë afariste si dhe po na shkaktohet dëm material financiar.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

NDËRMARRJA PRIVATE TREGTARE BAJRA 1 PRISHTINË

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të munds*

NËNDERMARRJA PRIVATE TREGTARE BAJRA PRISHTINË